

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i Audituesit të Pavarur	i-iv
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	3
Pasqyra e flukseve të parasë	4
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare	5-38



RSM ALBANIA

Rr. Skender Luarasi, sheshi Gjenerali
Jozef San Martin, Pallati 3, Hyrja 19,
Tiranë, Shqipëri
T: +355 69 706 6110
www.rsm.global/albania

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Drejtimin e Shoqërisë "Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor"

Raport mbi auditimin e pasqyrave financiare

Opinionin me Rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë "Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor" (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2022, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet më këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, duke përjashtuar efektet e mundshme të çështjeve së përshkruara në seksionin e raportit tonë "Baza për Opinionin me Rezervë", pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2022 si dhe performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion me Rezervë

1. Siç paraqitet në shënimin 2 dhe 22 të pasqyrave financiare të Shoqërisë, pasqyrat financiare përfshijnë aktivitetet e Drejtorise së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të Shoqërisë. Gjatë procedurave të përgatitjes së pasqyrave financiare, Shoqëria nuk ka eliminuar të ardhurat e gjeneruara nga shitja e produkteve të përpunuara (çertifikata, leje drejtimi, formularët, targat) nga Drejtoria e Targave dhe Shtypshkrimeve kundrejt Drejtorive të tjera Rajonale në shumën 201,528 mijë lekë (2021: 148,942 mijë lekë), praktikë e cila nuk është në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Për shkak të natyrës së regjistrimeve të Shoqërisë ne nuk jemi në gjendje të llogarisim efektin, që kryerja e këtyre eliminimeve do të kishte në të ardhurat e tjera, inventarin dhe kostot direkte në pasqyrat financiare.
2. Siç paraqitet në shënimin 31 të pasqyrave financiare, Shoqëria më datë 31 dhjetor 2022 ka disa çështje gjyqësore pezull me punonjës të larguar dhe palë të tjera të treta. Shoqëria nuk ka përlllogaritur provigjione për humbje të mundshme nga këto çështje gjyqësore, praktikë e cila nuk është në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Për shkak të natyrës së transaksioneve të shoqërisë ne nuk ishim në gjendje të përcaktonim nëse rregullime në zërin e shpenzime provizioni për çështje gjyqësore dhe fonde provizioni për çështje gjyqësore janë të nevojshme të raportoheshin në pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare dhe në pasqyrën e ndryshimeve në kapital më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022.

3. Shoqëria nuk ka kryer përlogaritjet e kërkuara nga SNRF 16 "Qiratë" dhe shënimet shpjeguese përkatëse praktikë e cila nuk është në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Për shkak të natyrës së transaksioneve të shoqërisë ne nuk ishim në gjendje të përcaktojmë rregullimet e nevojshme në zërat respektivë të pasqyrës së pozicionit financiar, pasqyrës së fitim humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrës së flukseve të parasë dhe pasqyrës së ndryshimeve në kapital më dhe për vitin që mbyllet 31 dhjetor 2022 dhe shënimet shpjeguese.
4. Shoqëria nuk ka llogaritur tatim fitimi të shtyrë siç kërkohet nga SNA 12. Për shkak të kufizimeve të efekteve të çështjeve të përshkruar më sipër, ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë në mënyra alternative rregullimet e nevojshme për tatimin e shtyrë në zërat respektivë të pasqyrës së pozicionit financiar, pasqyrës së fitim humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrës së flukseve të parasë dhe pasqyrës së ndryshimeve në kapital më dhe për vitin që mbyllet 31 dhjetor 2022.
5. Siç është paraqitur në pasqyrën e kapitalit, Shoqëria kryen ndryshime në rezervat kapitale për transaksione që lidhen me investimet në aktivet afatgjata materiale dhe jo-materiale të shoqërisë. Nëse Shoqëria nuk do të raportonte ndryshime në rezerva lidhur me investimet në aktivet afatgjata materiale dhe jo-materiale të Shoqërisë, fondi për investime në pasqyrën e pozicionit financiar do të zvogëlonte kapitalin themeltar, megjithatë, kapitali neto nuk do të ndryshonte. Gjithashtu, Shoqëria kryen ndryshime në krijimin e rezervave për detyrime aktuale bazuar në statut dhe për transaksione të tjera që lidhen me aktivitetin operacional të shoqërisë, praktikë e cila nuk është në përputhje me kërkesat e Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Për shkak të natyrës së transaksioneve të shoqërisë dhe të kufizimeve të efekteve të çështjeve të përshkruar më sipër, ne nuk ishim në gjendje të siguronim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme auditimi për të përcaktuar nëse rregullime në zërat përbërës të rezervave do të ishin të nevojshme të raportoheshin në pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e fitim humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse dhe në pasqyrën e ndryshimeve në kapital më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022.

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për ato kontrole të brendshme, që drejtimi i përcakton të nevojshme, për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, të shkatuara nga mashtrimi apo gabimi.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet e lidhura me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë, përveç se kur drejtimi synon të likujdojë shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose kur nuk ka alternative tjetër reale përveç sa më sipër.

Drejtimi dhe personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënime shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënime shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me Drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Raport për Informacione të Tjera

Informacione të tjera përfshijnë informacione përgatitur në përputhje me nenet 17, 18 dhe 19 të Ligjit Nr. 25\2018 Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e Tjera të Shoqërisë për vitin 2022 pritet të na vihen në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit.

Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me gabime materiale.

Nëse bazuar në punën e kryer ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë gabime materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt.

Elona Bisha
Elona Bisha

Auditues Ligjor



RSM Albania

Tiranë, 30 qershor 2023

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor*(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)***Pasqyra e pozicionit financiar**

	Shënime	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Aktive			
Aktivitet afatgjata			
Aktivitet afatgjata materiale	7	3,770,277,287	3,284,410,101
Aktivitet afatgjata jomateriale	8	198,206,788	199,882,287
Totali i aktiveve afatgjata		<u>3,968,484,075</u>	<u>3,484,292,388</u>
Aktivitet afatshkurtra			
Inventarë	9	287,110,842	227,154,302
Llogari të arkëtueshme tregtare	10	9,705,325	5,497,545
Hua të dhëna	11	429,099,135	-
Llogari të arkëtueshme të tjera	12	19,715,495	15,838,367
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	13	1,906,116	3,880,980
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	14	3,061,550,285	3,284,337,395
Totali i aktiveve afatshkurtra		<u>3,809,087,198</u>	<u>3,536,708,589</u>
Totali i aktiveve		<u>7,777,571,273</u>	<u>7,021,000,977</u>
Kapitali dhe Rezervat			
Kapitali themeltar		5,370,359,133	4,607,011,044
Rezerva ligjore		291,710,331	261,779,841
Rezerva Rivlerësimi		435,532,795	459,502,165
Fondi investime		(1,010,634,759)	(709,536,014)
Fitime të mbartura		81,572,359	57,602,997
Fitimi i ushtrimit		490,936,196	598,609,798
Totali i kapitalit	15	<u>5,659,476,055</u>	<u>5,274,969,831</u>
Detyrimet			
Detyrime afatgjata			
Grante	16	28,468,568	35,643,783
Totali i detyrimeve afatgjata		<u>28,468,568</u>	<u>35,643,783</u>
Detyrimet afatshkurtra			
Hua afatshkurtër	17	100,515,733	-
Llogari të pagueshme tregtare	18	229,997,822	196,440,529
Detyrime tatimore dhe të tjera	19	1,672,440,916	1,458,043,619
Të ardhura të shtyra e të tjera detyrime		5,835,170	3,670,692
Llogari të pagueshme të tjera	20	80,837,009	52,232,523
Totali i detyrimeve afatshkurtra		<u>2,089,626,650</u>	<u>1,710,387,363</u>
Totali i detyrimeve		<u>2,118,095,218</u>	<u>1,746,031,146</u>
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		<u>7,777,571,273</u>	<u>7,021,000,977</u>

Shënimet shpjeguese shoqëruese të faqeve 5- 38 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor*(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)***Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	21	2,694,877,114	2,477,698,761
Të ardhura të tjera	22	432,841,331	292,020,479
Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces		3,997,354	6,828,145
Total të ardhura		3,131,715,799	2,776,547,385
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	23	(511,402,075)	(394,217,394)
Shpenzime personeli	24	(1,831,275,853)	(1,479,058,595)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	7,8	(275,466,737)	(202,413,652)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	25	(383,557,842)	(420,977,239)
Total shpenzime		(3,001,702,507)	(2,496,666,880)
Të ardhura nga interesa	26	34,261,676	40,091,888
(Fitim)/Humbje nga diferencat e kursit		(2,707,265)	(1,196,144)
Të ardhura të tjera financiare	27	421,902,650	394,180,569
Fitimi para tatimit		583,470,353	712,956,818
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	28	(92,534,157)	(114,347,020)
Fitimi i vitit		490,936,196	598,609,798
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		23,969,370	57,602,997
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		514,905,566	656,212,795

Shënimet shpjeguese shoqëruese të faqeve 5- 38 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor*(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)***Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022**

	Kapitali	Rezerva Rivleresimi	Rezervat	Fitime të mbartura	Totali
Gjendja më 31 dhjetor 2020	3,259,495,614	517,105,162	593,238,542	137,463,192	4,507,302,510
Fitimi i vitit	-	-	-	598,609,797	598,609,797
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	(57,602,997)	-	57,602,997	0
Transferime ne rezerva	-	-	137,463,192	(137,463,192)	0
Transferime në kapital	1,118,838,977	-	(1,118,838,977)	-	0
Shtese kapitali	228,676,453	-	-	-	228,676,453
Pakësime të tjera	-	-	(59,618,929)	-	(59,618,929)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	4,607,011,044	459,502,165	(447,756,172)	656,212,794	5,274,969,831
Fitimi i vitit	-	-	-	490,936,196	490,936,196
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	(23,969,370)	-	23,969,370	-
Transferime ne rezerva	-	-	598,609,805	(598,609,805)	-
Transferime në kapital	755,651,395	-	(755,651,395)	-	-
Shtese kapitali	32,708,880	-	-	-	32,708,880
Pakesime te tjera	(25,012,186)	-	(114,126,666)	-	(139,138,851)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2022	5,370,359,133	435,532,795	(718,924,428)	572,508,555	5,659,476,055

Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 janë aprovuar nga drejtimi i Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe janë nënshkruar si më poshtë:

Drejtor i Përgjithshëm
Blendi Gonxhja

Drejtor Ekonomik
Rakip Duka

Përgjegjëse e Sektorit të Financës
Violeta Dervishi

Shënime shpjeguese shoqëruese të faqeve 5- 38 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

Pasqyra e flukseve të parasë

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Fluksi mjeteve monetare nga/perdorur në aktivitetin e shfrytëzimit:			
Fitimi vitit		490,936,196	598,609,797
<i>Rregullimet për zërat jomonetar:</i>			
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	7-8	273,407,974	201,078,728
Humbje nga dalje jashtë përdorimit e AAM	7	7,045,823	14,542,026
Amortizimi i granteve		(7,175,215)	(7,339,305)
<i>Ndryshimet në kapitalin neto</i>			
Rënie/(ritje) në të arkëtueshme dhe të tjera	10,12	(8,084,908)	28,106,205
Rënie/(ritje) në inventare	9	(59,956,538)	(3,315,104)
Rënie në shpenzime të shtyra dhe parapagime		1,974,863	14,899,021
Rritje në detyrimet e pagueshme dhe të tjera		277,426,157	845,342,299
Mjete monetare neto nga/ perdorur në aktivitetin e shfrytëzimit		975,574,352	1,691,923,667
Fluksi i mjeteve monetare nga/ përdorur në aktivitetin e investimit			
Blerje të aktiveve afatgjata materiale	7	(704,121,595)	(978,438,973)
Blerje të aktiveve afatgjata jomateriale	8	(51,529,800)	(140,400,000)
Hua të dhëna	11	(429,099,135)	-
Mjete monetare neto nga/përdorur në aktivitetin e investimit		(1,184,750,530)	(1,118,838,973)
Fluksi i mjeteve monetare nga/përdorur në aktivitetin e financimit			
Hua të marra	17	100,515,733	-
Përdorimi i fondeve të kapitalit dhe rezervave	15	(114,126,666)	(59,618,937)
Mjete monetare neto nga/përdorur në aktivitetin e financimit		(13,610,933)	(59,618,937)
Rritje/(rënie) neto në mjetet monetare dhe ekuivalente me to			
		(222,787,110)	513,465,757
Mjete monetare dhe ekuivalente të mjeteve monetare më 1 janar 2022	14	3,284,337,395	2,770,871,638
Mjete monetare dhe ekuivalente të mjeteve monetare më 31 dhjetor 2022	14	3,061,550,285	3,284,337,395

Shënimet shpjeguese shoqëruese të faqeve 5- 38 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor **Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022**

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm

Krijimi i DPSHTRR

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (në vijim referuar si 'DPSHTRR' ose 'Shoqëria') është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave (V.K.M) nr.343, datë 21.07.1999, "Për Krijimin e DPSHTRR" si person juridik publik, jobuxhetor.

Në vendimin e krijimit është përcaktuar se:

- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, do të jetë në varësi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit.
- Kjo Drejtori do të jetë institucion shtetëror, me statusin e personit juridik, publik, i cili do të vetëfinancohet.
- Kompetencat, detyrat dhe të drejtat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe të drejtorive rajonale do të përcaktohen në statutin e kësaj Drejtorie, e cila miratohet nga Ministri.
- Emërimi i drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor bëhet nga Kryeministri me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit.
- Objekti i veprimtarisë së kësaj drejtorie do të jetë shërbimi ndaj subjekteve, shtetërore dhe private, në veprimtarinë e transportit rrugor, për regjistrimin e mjeteve, për ndërrimin e pronësisë së tyre, pajisjen me targa, për kontrollin teknik të mjeteve, për pajisjen e mjeteve me leje-drejtimi, për ngritjen dhe informatizimin e regjistrit kombëtar të mjeteve e të drejtuesve të mjeteve dhe për transmetimin e menjëhershëm të të dhënave të kërkuara nga policia e rendit, si dhe dhënien e licencave.

Statuti i DPSHTRR

Në 19 Shkurt 2019, mbështetur në V.K.M. nr.343, datë 21.07.1999, Ministri për Infrastrukturen dhe Energjinë, ka miratuar statutin e ri të Shoqërisë.

Sipas statutit, DPSHTRR krijohet për të ushtruar veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi, që rregullon fushën e transportit rrugor dhe statutin e saj, për një afat kohor të pacaktuar.

Sipas statutit, veprimtaria financiare kryhet në zbatim të ligjit nr.7582, datë 13.07.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore", i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të ligjit. DPSHTRR-ja mban kontabilitetin e saj në pajtim me ligjin nr.25/2018, "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Drejtimi i DPSHTRR

DPSHTRR drejtohet nga Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm.

Këshilli Drejtues, përbëhet nga pesë anëtarë, të cilët emërohen nga Ministri përgjegjës për transportin rrugor. Drejtor i Përgjithshëm është Z.Blendi Gonxha.

Drejtoritë Rajonale janë në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme dhe janë pjesë përbërëse e strukturës së saj. Drejtimi dhe administrimi i Drejtorive Rajonale ushtrohet nga Drejtori i saj, i cili përgjigjet për të gjithë veprimtarinë e Drejtorisë Rajonale. Drejtoritë Rajonale e zhvillojnë aktivitetin e tyre në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi, udhëzimet, urdhërat, aktet administrative të DPSHTRR-së dhe Statutit.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm (vazhdim)

Këshilli Drejtues i DPSHTRR përbëhet nga 5 anëtarë:

Z. Hantin Bonati	Kryetar
Z. Maksim Tashi	Anëtar
Znj. Edesa Gega	Anëtare
Z. Enea Karakaçi	Anëtar
Z. Salarjon Totaj	Anëtar

Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është shërbimi ndaj subjekteve fizike dhe juridike, shtetërore dhe private, në veprimtarinë e transportit rrugor për:

- a) regjistrimin e mjeteve (pajisjen e tyre me targa dhe leje qarkullimi, regjistrimin e pronarëve të tyre dhe pajisjen me çertifikatë pronësie, licensimin dhe çertifikimin e mjeteve), sipas akteve ligjore dhe nën ligjore në fuqi.
- b) monitorimin e kualifikimit të drejtuesve të mjeteve rrugore dhe pajisjen e tyre me leje drejtimi;
- c) kontrollin teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore, nëse me ligj nuk është vendosur ndryshe;
- d) krijimin e regjistrimit elektronik kombëtar të mjeteve dhe drejtuesve të tyre si dhe transmetimin e të dhënave që kërkohen nga organet e përcaktuara me ligj;
- e) kryerjen e veprimtarisë së agjentit tatimor, sipas përcaktimeve ligjore;
- f) dhënien e lejeve të veprimtarisë të autoshkollave, dëshmitë e taksistit, instruktorëve të praktikës, teorisë etj;
- g) trajnimin e specializuar në fushat e transportit rrugor, për pajisjen e aplikantëve me dëshminë e aftësisë profesionale;
- h) mbikëqyrjen e kualifikuar të operatorëve të transportit rrugor, gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre, si dhe
- i) çdo objekt tjetër veprimtarie në shërbimin e transportit rrugor të lejuar nga ligji dhe aktet nënligjore në fuqi.
- j) kryerjen e veprimtarisë së agjentit në sigurime, sipas përcaktimeve ligjore.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor **Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022**

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

2. Baza e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare shoqëruese janë përgatitur në përputhje me Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018, "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", duke aplikuar Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Pasqyrat financiare të DPSHTRR-së hartohen si kombinim i pasqyrave financiare të Drejtorive Rajonale.

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti për Interpretimet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KIRFN") të BSNK-së.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç klases së Aktiveve Afatgjata Materiale dhe Aktiveve Afatgjata Jo-Materiale, të cilat paraqiten me vlerën e rivlerësuar. Këto pasqyra financiare janë përgatitur dhe prezantuar në Lek Shqiptar "LEK".

2.3 Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të pa parashikuar.

Në shënimin 6 janë shpalosur pasiguritë në lidhje me ngjarjet dhe kushtet që mund të hedhin dyshime mbi aftësinë e Shoqërisë për të për të vazhduar në bazë të parimit të vijimësisë.

3. Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacion mbi kushtet më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare dhe në shënimin 5. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

4. Politikat kryesore kontabël

4.1 Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit që rezultojnë nga kryerja e transaksioneve të tilla dhe nga konvertimi i zërave monetarë në monedhë të huaj me kursin e fundit të vitit janë njohur në fitim dhe humbje.

Zërat jo monetarë nuk janë ri-konvertuar në fund të vitit dhe janë matur në bazë të kostos historike (konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit), përveç zërave jo-monetarë të matur me vlerën e drejtë të cilët konvertohen me kursin e datës kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Kurset zyrtare të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e raportimit janë si vijon:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Euro/Lek	114.23	120.76
USD/ Lek	107.05	106.54

4.2 Aktivët Afatgjatë Materiale (AAM)

4.2.1 Njohja dhe matja

Vlerësimi fillestar i elementeve që plotësojnë kriteret për njohjen si AAM në pasqyën e pozicionit financiar është bërë me kosto blerje plus kosto të tjera të drejtpërdrejta, që lidhen me sjelljen e aktivitetit në vendndodhjen dhe kushtet e nevojshme për funksionimin e tij, sipas qëllimeve të shoqërisë (përfshirë koston e prodhimit të aktivitetit).

Pas njohjes fillestare, Shoqëria ka zgjedhur modelin e rivlerësimit, për matjen e mëpasshme të të gjitha klasave të AAM-ve, të cilat mbarten me shumën e rivlerësuar, që është vlera e drejtë e zërave në datën e rivlerësimit minus ndonjë amortizim të mëpasshëm të akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësim. Rivlerësimet do të bëhen në mënyrë të rregullt të mjaftueshme që të sigurohet se vlera kontabël (neto) e aktivitetit nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohej nëse do të përdorej vlera e drejtë në fund të periudhës raportuese. Rivlerësimi i fundit është bërë në datën 31/12/2019, efektet e të cilit u regjistruan në datën 01/01/2020. Rivlerësimet do të bëhen në mënyrë konsistente për të gjithë klasën në të cilin aktiviteti i rivlerësuar i përket.

Rivlerësimet në rritje do të kalojnë në Të Ardhura të Tjera Gjithëpërfshirëse dhe do të akumulohen në seksionin e kapitalit në zërin Rezerva nga Rivlerësimi. Megjithatë, rivlerësimi në rritje në masën që eliminon rivlerësimet në ulje të periudhave të mëparshme do të kalojë në Pasqyrën e Të Ardhurave dhe Shpenzimeve.

Nëse vlera kontabël e një aktiviteti zvogëlohet si rezultat i një rivlerësimi, ulja do të njihet në fitim ose humbje. Megjithatë, ulja do të njihet në të ardhura të tjera përmbledhëse në masën e çdo tepricë kreditore që ekziston në tepricën e rivlerësimit në lidhje me atë aktivitet. Ulja e njohur në të ardhurat e tjera përmbledhëse redukton shumën e akumuluar në kapital nën zërin e tepricës së rezervës nga rivlerësimi.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

4. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

4.2.2 Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

4.2.3 Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet mbi jetën e vlerësuar të çdo pjesë të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e hyrjes në përdorim të aktivitetit. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën me të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve. Normat vjetore të amortizimit të përdorura, bazuar në Ligjin 8438 datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" janë si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Toka	n/a	n/a
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Makineri e paisje	Vlera e mbetur	20%
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Pajisje zyre	Vlera e mbetur	25%
Pajisje kompjuterike	Vlera e mbetur	25%

4.2.4 Ç'regjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale ç'regjistrohet kur nuk priten me përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo shitja ose kur nxirret jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale përcaktohen sipas shumës së tyre të mbartur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të ushtrimit.

4.3 Aktivitet afatgjata jo materiale

Aktivitet afatgjata jo materiale, të cilat konsistojnë në programe, janë paraqitur me vlerën e drejtë minus amortizimin e akumuluar dhe humbjen e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka. Amortizimi llogaritet duke përdorur metodën mbi vlerën e mbetur. Norma e amortizimit e përdorur për aktivitet afatgjata jo materiale është 25%. Jeta e dobishme dhe metoda e amortizimit rishikohen në fund të çdo periudhe raportimi dhe efektet e ndonjë ndryshimi në vlerësim rregjistrohen në bazë prospektive.

Rivlerësimet do të bëhen në mënyrë konsistente për të gjithë klasën në të cilin aktivi i rivlerësuar i përket. Rivlerësimet në rritje do të kalojnë në Të Ardhura të Tjera Gjithëpërfshirëse dhe do të akumulohen në seksionin e kapitalit në zërin Rezerva nga Rivlerësimi. Megjithatë, rivlerësimi në rritje në masën që eliminon rivlerësimet në ulje të periudhave të mëparshme do të kalojë në Pasqyrën e Të Ardhurave dhe Shpenzimeve.

Nëse vlera kontabël e një aktivi zvogëlohet si rezultat i një rivlerësimi, ulja do të njihet në fitim ose humbje. Megjithatë, ulja do të njihet në të ardhura të tjera përmbledhëse në masën e çdo tepricë kreditore që ekziston në tepricën e rivlerësimit në lidhje me atë aktiv. Ulja e njohur në të ardhurat e tjera përmbledhëse redukton shumën e akumuluar në kapital nën zërin e tepricës së rezervës nga rivlerësimi.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

4. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

4.4 Instrumentat Financiare

(i) Njohja dhe matja fillestare

Të gjitha aktivet dhe detyrimet financiare njihen fillimisht në datën kur shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Blerjet apo shitjet e aktiveve financiare njihen në datën e tregtimit në të cilën shoqëria merr angazhimin për të blerë ose shitur aktivin. Një aktiv ose detyrim financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejt me blerjen ose shitjen e tij.

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare në arkë dhe në bankë huatë të arkëtueshme, hua të pagueshme dhe llogari të pagueshme.

(ii) Klasifikimi

Në njohjen fillestare, një aktiv financiar klasifikohet si i matur me: koston e amortizuar ose vlerën e drejte nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse ose vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Një aktiv financiar matet me koston e amortizuar nëse plotëson të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk është përcaktuar sime vlerën e drejte nëpërmjet fitimit ose humbjes :

- aktivi mbahet sipas modelit të biznesit objektivi i të cilit është mbajtja e aktivit për tu arkëtuar: dhe flukset kontraktuale monetare dhe kushtet kontraktuale të aktivit financiar të cilat lindin në datat specifike të flukseve monetare të cilat janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit (SPPI).

Instrumentet e borxhit të matshme si me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse vetëm nëse plotësohen të gjitha kushtet dhe nuk janë përcaktuar si vlerën e drejte nëpërmjet fitimit ose humbjes:

- aktivi mbahet sipas modelit të biznesit objektivi i të cilit është arritja njëkohësisht mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe shitjen e aktiveve financiare;
- dhe kushtet kontraktuale të aktiveve financiare të cilat lindin në një datë specifike të flukseve monetare të cilat janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit SPPI.

(iii) Vlerësimi i modelit të biznesit

Në vlerësimin e objektivit të modelit të biznesit, Shoqëria konsideron informacionin e mëposhtëm:

- Politikat dhe objektivat e deklaruara për portofolin dhe veprimet e tyre në praktikë, duke përfshirë nëse strategjia e drejtimit fokusohet në krijimin e të ardhurave nga interesi kontraktual;
- Mënyra e vlerësimit dhe raportimit të performancës së portofolit tek drejtuesit e Shoqërisë;
- Rreziku që ndikon performancën e modelit të biznesit (dhe aktivet financiare të mbajtura sipas atij modelit të biznesit) dhe si këto rreziqe menaxhohen; dhe
- Frekuencën e pritshme të shitjeve në vlerën dhe kohë

Qasja e modelit të biznesit është bazuar në mënyrë të arsyeshme në skenarët e pritshëm pa marrë "skenarin më të keq" apo "skenarin nën stres" në llogaritje. Nëse flukset e mjeteve monetare, pas njohjes fillestare realizohen në një mënyrë që ndryshon nga pritshmëritë fillestare të shoqërisë, Shoqëria nuk ndryshon klasifikimin e aktiveve të mbetura financiare të mbajtura në atë model biznesi, por përfshin këtë informacion gjatë vlerësimit të aktiveve financiare të sapo krijuara ose të blera.

Shoqëria klasifikon aktivet e veta financiare duke u bazuar në modelin e biznesit dhe testit SPPI, si mbajtur për tu arkëtuar.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

4. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

Vlerësimet nëse flukset monetare kontraktuale janë pagesa të vetme të principalit dhe interesit.

Në vlerësimin nëse flukset monetare kontraktuale janë pagesa të vetme të principalit dhe interesit, Shoqëria konsideron termat kontraktuale dhe Instrumentet. Kjo përfshin vlerësimin nëse aktivi financiar përmban terma kontraktual të cilat mund të ndryshojnë kohen ose shumën e flukseve hyrëse aq sa mund të mos përmbushë këtë kusht.

Për qëllime të këtij vlerësimi "Principalit" është përcaktuar me vlerën e drejtë të aktivitetit financiar në njohjen fillestare. "Interesi" është përcaktuar si vlera në kohë e parasë për këtë rrezik të lidhur me shumën e papaguar të principalit në një periudhë të caktuar duke përfshirë rrezikun bazë të kredisë dhe kostot (p.sh. rrezikun e likuiditetit dhe kostot administrative) gjithashtu edhe marzhet e fitimit. Të gjitha aktivitetet financiare kanë kaluar testin SPPI (pagesa të vetme të Principalit dhe interesit) dhe aktivitetet financiare.

Riklasifikimi

Aktivitetet financiare nuk janë riklasifikuar pas njohjes së tyre fillestare. Nuk ka klasifikime të ndodhura gjatë vitit 2022 dhe 2021.

Çregjistrimi

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivi financiar mbarojnë, ose kur ajo i transferon të drejtën kontraktuale për arkëtimin e flukseve monetare nga aktivi financiar një pale tjetër, pa mbajtur kontrollin ose të gjitha rreziqet e pronësisë së aktivitetit financiar. Interesi nga aktivitetet financiare të transferuara që përfitohet ose mbahet nga Shoqëria njihet si një aktiv ose detyrim i veçantë.

Në çregjistrimin e një aktiviteti financiar diferenca midis shumës së mbartur të aktivitetit (ose shumës së mbartur të shpërndarë sipas pjesës së aktivitetit të çregjistruar) dhe shume se (i) konsiderueshme për tu marrë (përfshirë çdo aktiv të ri të marrë duke zbritur detyrimet e reja të supozuara) dhe (ii) çdo të ardhur ose humbje të akumuluar e cila është e njohur në OCI, njihet në fitim ose humbje.

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale mbarojnë, janë shlyer ose janë anuluar. Shoqëria kryen transaksione me anë të të cilave transferon aktivitetet të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por në të njëjtën kohë mbaron të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivitetit të transferuar, ose një pjesë të tyre. Nëse mbaron të gjitha rreziqet dhe përfitimet, atëherë aktivitetet e transferuara vazhdojnë të njihen në pasqyrën e pozicionit financiar. Transferimi i aktiveve ku ruhen kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet, përfshin huadhënien e letrave me vlerë dhe transaksionet e riblerjeve.

Kur aktivitetet i shiten një pale të tretë me një përqindje totale aktuale të shkëmbimit të kthimit mbi aktivitetet e transferuara, transaksioni llogaritet si një transaksion financiar i siguruar i ngjashëm me transaksionet e riblerjes.

Në disa transaksione të caktuara ku Shoqëria as nuk mbaron dhe as nuk transferon rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivitetin financiar, ajo çregjistron aktivitetin nëse e humbet kontrollin mbi aktivitetin. Të drejtat dhe detyrimet e mbajtura gjatë transferimit njihen më vete sipas rastit si aktive ose detyrime. Në transferime ku kontrolli mbi aktivitetin ruhet, Shoqëria vazhdon të njohë aktivitetin sipas shkallës së përfshirjes së vazhdueshme të saj në aktivitetin financiar, e përcaktuar kjo nga masa e ekspozimit ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivitetit të transferuar.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

4. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

Matja me kosto të amortizuar

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi financiar matet në momentin fillestar, duke i zbritur pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim, minus çdo zbritje për efekt provizioni.

Matja me vlerë të drejtë

Vlera e drejtë është çmimi që do të pranohej për të shitur një aktiv ose paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të zakonshëm në princip midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes, ose në mungesë të saj, në tregun më të favorshëm në të cilin Shoqëria ka qasje në atë datë. Vlera e drejtë e një aktivi pasqyron rrezikun e mosekzekutimit.

Kur është e mundur, Shoqëria mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg konsiderohet aktiv nëse transaksionet për një aktiv ose detyrim ndodhin me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacion të çmimeve në baza të vazhdueshme.

Nëse nuk ka çmim të kuotuar në një treg aktiv, atëherë Shoqëria përdor teknika vlerësimi të cilat maksimizojnë përdorimin e të dhënave të mbikëqyrura dhe minimizojnë përdorimin e inputeve jo të vëzhgueshme. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do të marrin parasysh në vendosjen e çmimit të një transaksioni.

Treguesi më i mirë i vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare është zakonisht çmimi i transaksionit, p.sh. vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të arkëtuar. Nëse Shoqëria përcakton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe se vlera e drejtë nuk përcaktohet as nga një çmim i kuotuar në një treg aktiv për një aktiv ose detyrim të ngjashëm dhe as nuk bazohet në një teknikë vlerësimi që përdor të dhëna të njohura në tregje, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë, dhe rregullohet për diferencën midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit.

Shoqëria mat vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e metodës së mëposhtme:

- Niveli 1: Çmimi i tregut në një treg aktiv për një instrument identik.
- Niveli 2: Teknikat e vlerësimit bazuar në inputet e vëzhguara. Kjo kategori përfshin instrumenta të vlerësuar sipas: çmimit të tregut në një treg aktiv për një instrument të ngjashëm, çmime tregu për instrumente të ngjashëm në tregje të cilat konsiderohen më pak se aktive ose teknika të tjera vlerësimi ku të gjithë inputet e rëndësishme janë të matshme në mënyre direkte ose indirekte nga tregu.
- Niveli 3: Teknikat e vlerësimit duke përdorur inpute të rëndësishme të pakontrollueshme. Kjo kategori përfshin të gjitha instrumentet kur teknikat e vlerësimit përfshijnë inpute jo të bazuara në të dhënat e mbikëqyrura dhe inputet e pakontrolluara mund të kenë një efekt domethënës në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumente që vlerësohen bazuar në çmimet e kuotuar për instrumente të ngjashme, kur kërkohen rregullime apo supozime të konsiderueshme të pakontrollueshme për të pasqyruar ndryshimet midis instrumenteve

Shoqëria për efekt të përcaktimit të vlerës së drejtë i kategorizon likuiditetet, llogarite të arkëtueshme dhe llogarite të pagueshme në nivelin 3.

Vlera e drejtë e parasë dhe e likuiditeteve, huave të dhëna, llogarive të arkëtueshme huave të marra dhe llogarive të pagueshme janë afersisht të barabarta me vlerën kontabël të dhënë, për shkak të maturimit të tyre afatshkurtër.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

4. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë tepricat e arkës, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat e vendosura në bankat tregtare vendase. Për qellime të pasqyrës së fluksit të parase, paraja dhe ekuivalentet të saj përfshijnë depozita pa afat dhe ato me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data fillestare. Likuiditetet dhe vlera arke të tjera maten më tej me koston e amortizuar pakësuar me humbjet nga zhvlerësimet.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Llogaritë e arkëtueshme afatshkurtra nuk skontohen.

Provizioni për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parase të skontuara me normën efektive të interesit.

Kërkesat për arketim vlerësohen me vlerën nominale minus humbjen nga zhvlerësimi. Ato nuk janë vlerësuar me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv për të llogaritur vlerën e interesit të papërfutur në pasqyrat financiare përderisa nuk ka efekte materiale të këtyre interesave në datën e mbylljes së pasqyrave financiare.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe me pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv nëse është materiale.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivative maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parase të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

4. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

4.5 Inventari

Inventarët e blerë janë vlerësuar me kosto blerje plus të gjitha shpenzimet që lidhen me to, për t'i sjelle në kushtet dhe vendodhjen aktuale. Në koston e inventareve të prodhuar përveç kostove të drejtpërdrejta përfshihet dhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme, e cila llogaritet bazuar në kapacitetet normale prodhuese.

Inventari matet me më të voglën midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është vlerësuar me çmimin e shitjes gjatë aktivitetit normal minus koston e përfundimit dhe shpenzimet e shitjes. Kosto e inventarit në fund të periudhës kontabël matet me supozimin që kosto mesatare e ponderuar reflekton koston reale historike të inventarit të mbetur.

Nëse vlera neto e realizueshme është me e vogël sesa kosto historike sipas metodës së koston mesatare të ponderuar, atëherë inventari zhvlerësohet deri në nivelin e vlerës neto të realizueshme dhe diferencat kalojnë në humbje nga zhvlerësimi në Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve.

4.6 Qiratë

Qiratë klasifikohen si qira financiare kurdoherë kur termat e qirasë transferojnë nga qiradhënësi te qiramarrësi në mënyrë domethënëse të gjitha risqet dhe përfitimet e pronësise se aktivitetit. Qeratë e tjera klasifikohen si qera operationale. Totali i pagesave të bera për qeratë operationale, ka kaluar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas termave të kontratave të qerasë.

4.7 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij.

Provizionet përcaktohen duke skontuar (nëse është materiale) flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohe të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë të mbylljes së pasqyrave financiare dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet kthehen. Provizionet përdoren vetëm për qëllimin që janë njohur fillimisht. Ato nuk njihen për humbjet e ardhshme operative. Aktivitetet e kushtëzuara nuk njihen por paraqiten në shënime kur janë sinjifikative.

4.8 Grantet për investime

Grantet për investime përbëhen nga aktive afatgjata të marra, pa pagesë nga institucionet shtetërore dhe private dhe përfaqësojnë vlerën neto të tyre pas zbritjes së amortizimit të akumuluar. Një vlerë e njëjtë me amortizimin e vitit njihet edhe në të ardhurat e vitit në zërin "Të ardhura nga grante për aktive materiale të falura". Grantet njihen si të ardhura në mënyrë sistematike gjatë periudhës kontabël, në të njëjtën mënyrë siç do të regjistrohen edhe shpenzimet që këto grante do të kompensojnë.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

4. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

4.9 Të ardhurat

Të ardhurat lindin kryesisht nga ofrimi i shërbimit të Shoqërisë dhe Shitja e materialeve të lidhura me shërbimet e ofruara. Për të përcaktuar nëse do të njohë të ardhurat, Shoqëria ndjek një proces me 5 hapa:

- 1 Identifikimi i kontratës me një klient
- 2 Identifikimi i detyrimeve të performancës
- 3 Përcaktimi i çmimit të transaksionit
- 4 Shpërndarja e çmimit të transaksionit në detyrimet e performancës dhe më pas
- 5 Njohja e të ardhurave kur/si detyrimi(et) e performancës janë përmbushur.

Të ardhurat nga shërbimet

Të ardhurat nga shërbimet regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në proporcion me përfundimin e shërbimit në datën e raportimit. Të ardhurat që lidhen me aktivitetin kryesor janë të pasqyruara në kohën e përfitimit të tyre. Shoqëria krijon të ardhura nga tarifatat dhe komisionet nga një shumëllojshmëri shërbimesh që u ofron klientëve të saj. Të ardhurat nga tarifatat dhe komisionet njihen në atë masë që pasqyrojnë shumën për të cilën Shoqëria pret të ketë të drejtë të marrë në këmbim të ofrimit të shërbimeve.

Të ardhura nga shitja

Të ardhurat nga shitja njihen plotësisht në momentin e dorezimit kur kryhet shitja dhe/ose shërbimi.

Detyrimet e performancës, si dhe kohëzgjatja e marrjes së tyre, identifikohen dhe përcaktohen në fillim të kontratës. Kur Shoqëria ofron një shërbim për klientët e saj, shërbimi faturohet përgjithësisht pas përfitimit të menjëhershëm të shërbimit të ofruar në datën e caktuar ose në fund të kontratës për një shërbim të ofruar për një periudhë të caktuar kohore.

4.10 Shpenzimet

Të gjitha shpenzimet njihen në pasqyrat financiare në momentin që ndodhin dhe si të tilla kryesisht justifikohen nga faturat përkatëse. Shoqëria zbaton parimin e të drejtave të konstatuara në njohjen e shpenzimeve.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

4. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

4.11 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen në fitim ose humbje bazuar në metodën efektive të interesit. Norma efektive e interesit është norma që skonton arkëtimet dhe pagesat e pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së aktivit ose detyrimit financiar

- vlerën bruto të mbetur të aktivit financiar ose
- kosto të amortizuara të detyrimit financiar.

Gjatë përlogaritjes së normës efektive të interesit për instrumentet financiare të ndryshëm nga aktivet e blera ose aktive të gjeneruara të zhvlerësuara, Shoqëria vlerëson flukset monetare të ardhshme duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar. Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin kostot dhe tarifat e transaksionit dhe njësitë e paguara ose të pranuar që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e transaksionit përfshijnë kostot shtesë që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes ose emetimit të një aktivi ose detyrimi financiar.

4.12 Tatimi mbi fitimin

Norma e aplikuar për Tatim fitimi për vitin 2022 është 15 % (2021; 15%) sipas legjislacionit fiskal në fuqi. Tatim fitimi për periudhën korente dhe ai i papaguar për periudhat e mëparshme njihen si detyrim afatshkurtër në pasqyrën e pozicionit financiar.

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në humbje ose fitim përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital, ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Interesat dhe penalitetet që lidhen me tatimin mbi të ardhurat, duke përfshirë trajtimet e pasigurta tatimore, trajtohen sipas SNK 37 *Provizionet, Detyrimet dhe aktivet e Kushtëzuara*.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet ose arkëtohet mbi fitimin ose humbjen e tatueshme të vitit, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme. Shuma e tatimit aktual të pagueshëm ose të arkëtueshëm është vlerësimi më i mirë i shumës së tatimit që pritet të paguhet ose të merret, i cili reflekton pasigurinë në lidhje me tatimet mbi të ardhurat, nëse ka. Ai matet duke përdorur normat e taksave të miratuara ose të miratuara në mënyrë thelbësore në datën e raportimit. Aktivet dhe detyrimet tatimore aktuale janë kompensuar (netuar) vetëm nëse plotësohen disa kriteret.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet lidhur me diferencat e përkohshme ndërmjet vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerat e përdorura për qëllime tatimore.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për humbjen tatimore të papërdorur, kreditimet tatimore të papërdorura dhe diferencat e përkohshme të zbritshme deri në masën që është e mundur që të kenë fitime të tatueshme në të ardhmen, kundrejt të cilave ato mund të përdoren. Fitimet e ardhshme të tatueshme përcaktohen në bazë të planeve të biznesit. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në masën që nuk është më e mundur që të realizohet përfitim fiskal; Këto zvogëlime rimerren, kur mundësia e fitimit të ardhshëm tatimor përmirësohet.

Aktivitet tatimore të shtyra të panjohura rishikohen në çdo datë raportimi dhe njihen për aq sa është e mundur që përfitimi tatimor të realizohet. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të zbatohen mbi diferencat e përkohshme të cilat kthehen, në bazë të ligjeve në fuqi ose miratuar në datën e raportimit financiar.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

4. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

4.13 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Kontributet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave kur lind detyrimi për to. Shoqëria ka lidhur dhe një kontratë për antarësimin në fondin e pensionit privat suplementar të personelit, referuar ligjit nr 10197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar".

5. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

5.1. Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Disa standarde të cilat janë bërë efektive nga 1 Janari 2022 dhe rrjedhimisht kanë hyrë në fuqi, nuk kanë ndikim të rëndësishëm në rezultatin apo pozicionin financiar të Shoqërisë.

Këto ndryshime nuk kanë një ndikim të rëndësishëm në këto Pasqyra Financiare dhe për këtë arsye shpalosjet nuk janë bërë.

5.2. Standardet dhe interpretimet të lëshuara, por ende nuk janë adoptuar nga shoqëria

Standardet dhe ndryshimet që nuk janë ende efektive dhe nuk janë miratuar herët nga Shoqëria përfshijnë:

- SNRF 17 Kontratat e Sigurimit
- Ndryshimet në SNRF 17 Kontratat e Sigurimit (Ndryshimet në SNRF 17 dhe SNRF 4)
- Referencat në Kornizën Konceptuale
- Të ardhurat përpara përdorimit të synuar (Ndryshimet në SNK 16)
- Kontrata të rënda - Kostoja e përmbushjes së një kontrate (Ndryshimet në SNK 37)
- Përmirësimet Vjetore të Standardeve të SNRF-së Cikli 2018-2020 (Ndryshimet në SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16, SNK 41)
- Klasifikimi i detyrimeve si aktuale ose jo-korente (ndryshime në SNK 1)
- Tatimi i shyre nga aktive dhe detyrime të lindura nga një transaksion i vetëm

Këto ndryshime nuk pritet të kenë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare në periudhën e aplikimit fillestar dhe për këtë arsye shpalosjet nuk janë bërë.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor **Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022**

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

6. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit

Vlerësimet dhe gjykimet janë vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe janë bazuar në eksperiencat historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe pritshmërinë për ngjarjet e ardhshme për të cilat besohet të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave.

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime lidhur me të ardhmen. Rezultati i vlerësimeve kontabël, sipas përcaktimit, rrallë do të jetë i barabartë me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet të cilat kanë një risk të konsiderueshëm për shkaktimin e një sistemimi material në shumat e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë trajtuar si më poshtë.

Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve

Tatimi mbi fitimin dhe tatimet e shtyra

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar fiskal është i pasigurt. Kur rezultati përfundimtar tatimor ndryshon në mënyrë të rëndësishme me shumat të cilat janë regjistruar fillimisht, diferenca të tilla do të ndikojnë në aktivet dhe detyrimet aktuale ose të shtyra të tatimit në periudhën në të cilën është bërë një vlerësim i tillë. Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyre, për diferencat e perkoheshme midis vlerave kontabel dhe bazës tatimore të aktiveve dhe detyrimeve, gjatë vitit 2022 dhe vitit 2021.

Jeta e dobishme për aktive afatgjata materiale

Drejtimi i Shoqërisë ka rishikuar dhe vlerësuar jetën e dobishme të pronave, makinerive dhe pajisjeve në fund të çdo periudhe raportuese. Gjatë vitit aktual, Drejtimi ka vendosur që jeta e dobishme për aktive afatgjata materiale nuk ka ndryshuar.

Humbjet e pritshme nga zhvlerësimi i aktiveve financiare

Matja e humbjeve nga provigjonimi, sipas SNRF 9 gjatë gjithë kategorive të aktiveve financiare ne vetvete kërkon gjykim, veçanërisht, vlerësimi i shumës dhe koha e flukseve të ardhshme monetare dhe vlera e kolateralit gjatë përcaktimit të humbjes nga provigjonimi dhe vlerësimi i një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë. Këto vlerësime janë të nxitura nga një numër faktorësh, ndryshimet në të cilën mund të sjellin nivele të ndryshme provigjonimi.

Shoqëria përdor një qasje të thjeshtuar në kontabilitetin për të arkëtueshmet tregtare, huatë e dhena mjetet monetare dhe të tjera dhe regjistron provizionin për humbje si humbje të pritshme të kredisë gjatë gjithë jetës duke konsideruar mungesat e pritshme në flukset monetare kontraktuale, duke marrë parasysh mundësinë e mospagimit në çdo moment gjatë jetës së instrumentit financiar. Në llogaritjen e provizionit, Shoqëria përdor përvojën historike, treguesit e jashtëm dhe informacionin e ardhshëm për të llogaritur humbjet e pritshme nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Me 31 dhjetor 2022 Drejtimi ka vlerësuar se nuk pret humbje për aktivet financiare të shoqërisë.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor **Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022**

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

6 Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit - vazhdim

Inventari

Drejtimi vlerëson vlerat neto të realizueshme të inventarëve, duke marrë parasysh evidencën më të besueshme të disponueshme në çdo datë raportimi. Realizimi i ardhshëm i këtyre inventarëve mund të ndikohet nga teknologjia e ardhshme ose ndryshime të tjera të nxitura nga tregu që mund të ulin çmimet e shitjes në të ardhmen.

Vlerësimi i parimit të vijimësisë

Më 31 dhjetor 2022, kapitali i Shoqërisë arrin në 5,659,476 mijë Lekë (2021: 5,274,969 mijë Lekë), dhe fitimi neto për vitin 2022 arrin në 490,936 mijë Lekë (2021: 598,610 mijë Lekë).

Fitimi Bruto i DPSHTRR është me ulje në krahasim me vitin 2021 si rezultat i rritjes së shpenzimeve, kryesisht rritjes së shpenzimeve të personelit nga rritja në numrin e punonjësve dhe rritja e pagave si edhe shpenzimeve të amortizimit, në linjë me rritjen e investimeve sipas programeve të investimeve për permisimin e cilësisë së shërbimeve, në të gjitha ambientet ku ofrohen shërbimet e shoqërisë.

Megjithatë, Shoqëria ka arritur të rezultojë me fitim gjatë vitit 2022 dhe parashikon të vijojë aktivitetet e saj me fitim. Aktivitetet e Shoqërisë janë të përcaktuara në statut dhe në ligjin për DPSHRR (shënimi 1) duke e bërë Shoqërinë ofruesin e vetëm në vend për shërbimet që ajo ofron.

Shoqëria konsideron rrezikun e likuiditetit në planet e programeve vjetore dhe afatmesme të miratuara nga Këshilli Drejtues. Shoqëria merr masa në mënyrë të vazhdueshme për t'u siguruar që të ruajë raportet e likuiditetit dhe profitabilitetit sipas programeve ekonomike dhe buxheteve të miratuar nga Këshilli Drejtues.

Drejtimi i Shoqërisë ka bërë një vlerësim të aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë duke marrë parasysh të gjithë faktorët e përmendur më lart dhe është i kënaqur që Shoqëria ka burime të mjetueshme për të vijuar aktivitetet e saj për një të ardhme të parashikueshme. Për më tepër, Drejtimi nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie materiale që mund të hedhë dyshime të mëdha mbi aftësinë e vijimësisë së Shoqërisë. Për këto arsye, pasqyrat financiare vazhdojnë të përgatiten mbi bazën e parimit të vijimësisë.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

7. Aktivet Afatgjata Materiale

	Toka	Ndërtesa	Makineri dhe Pajisje	Automjetet	Pajisje Zyrash	Pajisje Informatike	Aktive të tjera	AAM në proçes	Totali
Kosto									
Më 01 janar 2021	688,959,530	960,504,790	182,739,534	39,777,523	67,091,591	201,750,679	1,728,408	223,281,394	2,365,833,449
Shtesa nga blerja	96,942,197	369,141,980	20,214,770	19,377,599	51,124,911	82,034,132	-	1,116,306,651	1,755,142,240
Shtesa nga AAM e koncensionit SGS	52,787,260	56,416,558	117,256,325	-	495,090	1,671,220	-	-	228,626,453
Shtesa nga Grantet	-	-	-	-	6,645,309	545,000	-	-	7,190,309
Riklasifikime	-	-	-	-	(259,000)	259,750	-	-	750
Pakësime	-	(26,764,034)	(2,824,948)	(7,740,552)	(20,183,318)	(12,186,973)	-	(776,703,267)	(846,403,092)
Më 31 dhjetor 2021	838,688,987	1,359,299,294	317,385,681	51,414,570	104,914,583	274,073,808	1,728,408	562,884,778	3,510,390,109
Amortizim i akumuluar									
Më 01 janar 2021	-	(28,744,242)	(35,672,037)	(7,851,746)	(9,816,910)	(34,433,819)	-	-	(116,518,754)
Amortizimi i vitit	-	(51,410,371)	(43,431,594)	(8,481,626)	(12,456,698)	(48,838,766)	-	-	(164,619,055)
Riklasifikime	-	-	-	-	169,957	(169,957)	-	-	-
Pakësime	-	14,714,490	2,728,948	7,023,138	18,910,455	11,780,770	-	-	55,157,801
Më 31 dhjetor 2021	-	(65,440,123)	(76,374,683)	(9,310,234)	(3,193,196)	(71,661,772)	-	-	(225,980,008)
Vlera kontabel neto									
Më 31 dhjetor 2021	838,688,987	1,293,859,171	241,010,998	42,104,336	101,721,387	202,412,036	1,728,408	562,884,778	3,284,410,101

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

7 Aktivet Afatgjata Materiale (vazhdim)

	Toka	Ndërtesa	Makineri dhe Pajisje	Automjetet	Pajisje Zyresh	Pajisje Informatike	Aktive të tjera	AAM në proces	Totali
Kosto ose vlera e tregut									
Më 01 janar 2022	838,688,987	1,359,299,294	317,385,681	51,414,570	104,914,583	274,073,808	1,728,408	562,884,789	3,510,390,120
Shtesa nga blerja	66,441,352	797,819,024	29,254,966	-	94,110,172	34,027,795	-	728,646,255	1,750,299,564
Shtesa nga transferime	30,357,572	4,813,932	-	-	-	-	-	-	35,171,504
Pakësime	-	(4,936,419)	(5,836,450)	(11,539,363)	(14,898,563)	(19,341,890)	-	(1,046,141,242)	(1,102,693,927)
Pakesime nga transferime	(4,991,198)	(31,295,547)	-	(2,545,479)	-	-	-	-	(38,832,224)
Sistemime	-	-	(2,000)	-	-	(34,727)	-	-	(36,727)
Aktive të tjera në përdorim	-	-	-	-	-	-	-	1,297,371	1,297,371
Më 31 dhjetor 2021	930,496,713	2,125,700,284	340,802,197	37,329,728	184,126,192	288,724,986	1,728,408	246,687,173	4,155,595,681
Amortizim i akumuluar									
Më 01 janar 2022	-	(65,440,123)	(76,374,683)	(9,310,234)	(3,193,197)	(71,661,772)	-	-	(225,980,009)
Amortizimi i vitit	-	(81,274,781)	(50,742,469)	(8,384,625)	(28,239,470)	(51,561,330)	-	-	(220,202,675)
Shtesa nga transferime	-	(2,462,624)	-	-	-	-	-	-	(2,462,624)
Jashtë përdorimit	-	2,586,011	3,954,277	11,332,856	13,933,592	17,700,131	-	-	49,506,867
Pakesime nga transferime	-	11,696,896	-	2,123,151	-	-	-	-	13,820,047
Më 31 dhjetor 2022	-	(134,894,621)	(123,162,875)	(4,238,852)	(17,499,075)	(105,522,971)	-	-	(385,318,394)
Vlera kontabel neto									
Më 31 dhjetor 2022	930,496,713	1,990,805,663	217,639,322	33,090,876	166,627,117	183,202,015	1,728,408	246,687,173	3,770,277,287

Nuk ka asnjë aktiv të qendrueshem të trupezuar të vendosur si kolateral deri më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor **Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022**

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

7 Aktivet Afatgjata Materiale (vazhdim)

Shtesat nga blerjet në aktivet afatgjata janë kryer bazuar ne fondet per investime të miratuara ne programin e investimeve të Miratuara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për investimet në drejtoritë rajonale.

Ne vitin 2022 eshte transferuar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, për Drejtorine Rajonale Korçë trua dhe ndërtesa.

Pakësimet në aktivet afatgjata ne vitin 2022 përbëhen nga dalje nga përdorimi të aktive në zbatim të Udhëzimit Nr 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" dhe Vendimeve të Këshillit Drejtues.

Pakesime nga transferime në vitin 2022 janë kryer bazuar në vendimet e Këshillit Drejtues dhe VKM, sipas Shkresës së MIE nga Drejtoria Rajonale Korce për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

Më 1 janar 2020, DPSHTRR ka kontabilizuar vlerat e rezultateve të rivlerësimit te aktiveve afatgjata materiale, në zbatim të shkresës me Nr. 22950, Prot, datë 29.10.2020, Vendimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë Nr.303 datë 25.07.2020 për Rivlerësimin e Aseteve Afatgjata Materiale të "DPSHTRR". Aktivet afatgjata në total janë rritur për vleren 346,902,623 Lek neto, nga ku 517,105,157 Lek (rritje në vlerë si pasojë e rivlerësimit) shkon në rritje të rezervës dhe 170,202,534 Lek (rënie në vlerë si pasojë e rivlerësimit) shkon si shpenzim i vitit.

Më 1 janar 2021, DPSHTRR ka kontabilizuar vlerat e rezultateve të vlerësimit te aktiveve afatgjata materiale, në zbatim të vendimit Nr. 85 datë 16.12.2020, të Këshillit Drejtues të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor "Për vlerësimin e jetës dobishme të aseteve të Qëndrave të Kontrollit Teknik të Automjeteve".Keto aktive afatgjata jane transferuar pa pagese në përfundim të periudhes koncesionare, nga Konkensionari "SGS Automotive Albania" shpk te Autoritetit Kontraktues "Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë", ne zbatim te Kontratës së Konkensionit "Për dhënien me Koncesion të Shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshem të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkio të tyre ne Republikën e Shqipërise", datë 03/09/2009, te lidhur ndermjet "Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (MPPTT)", e autorizuar si Autoritet Kontraktues, dhe shoqërisë "Societe Generale de Surveillance SA (SGS)", Konkensionari. Vlera e rezultatit te vleresimit prej 228,626,453 leke eshte regjistruar sipas klasave te aktive afatgjata ne kundërparti te Kapitalit te nenshkruar.

Në zërin Aktive në proces përfshihen pajisje kompjuterike dhe punime në proces për Drejtoritë Rajonale.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022

(Të gjitha shumatat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

8. Aktivet Afatgjata Jomateriale

	Programe kompjuterike	Totali
Kosto ose Vlera e tregut		
Gjendja më 1 janar 2021	124,126,937	124,126,937
Shtesa nga blerjet	140,400,000	140,400,000
Shtesa nga AAM e koncensionit SGS	50,000	50,000
Pakësime	(168,300)	(168,300)
Sistemime	(750)	(750)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	264,407,887	264,407,887
Amortizim i akumuluar		
Gjendja më 1 janar 2021	(28,234,227)	(28,234,227)
Amortizimi i vitit	(36,459,673)	(36,459,673)
Pakesime	168,300	168,300
Gjendja më 31 dhjetor 2021	(64,525,600)	(64,525,600)
Gjendja më 1 janar 2022	264,407,887	264,407,887
Shtesa nga blerjet	51,529,800	51,529,800
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2022	315,937,687	315,937,687
Amortizim i akumuluar		
Gjendja më 1 janar 2022	(64,525,600)	(64,525,600)
Amortizimi i vitit	(53,205,302)	(53,205,302)
Pakesime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2022	(117,730,902)	(117,730,902)
Vlera kontabël neto		
Gjendja më 31 dhjetor 2021	199,882,287	199,882,287
Gjendja më 31 dhjetor 2022	198,206,788	198,206,788

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

9. Inventarë

Gjendja e inventarit më 31 dhjetor 2022 dhe më 31 dhjetor 2021 është si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Materiale	230,781,840	182,096,684
Produkte te gatshme	30,619,521	26,622,166
Mallra	21,635,533	13,753,592
Inventar i imët	7,949,824	9,104,650
Zhvlerësim inventari	(3,875,876)	(4,422,790)
	<u>287,110,842</u>	<u>227,154,302</u>

10. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Klientë dhe debitorë të tjerë	9,705,325	5,497,545
	<u>9,705,325</u>	<u>5,497,545</u>

Kategorizimi i llogarive të arkëtueshme tregëtare për vitin 2022 dhe 2021 paraqitet si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Të pazhvlerësuara dhe pa vonesë	6,865,497	3,244,842
Të pazhvlerësuara dhe me vonesë	2,839,827	2,252,703
Të zhvlerësuara dhe pa vonesë	-	-
Të zhvlerësuara dhe në vonesë	-	-
	<u>9,705,325</u>	<u>5,497,545</u>

Të gjitha llogaritë e arkëtueshme kategorizohen me rrezik të ulët krediti.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

11. Hua të dhëna

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Hua e dhënë	421,200,000	-
Interes i përlogaritur	7,899,135	-
	<u>429,099,135</u>	<u>-</u>

Hua e dhënë i referohet kontrates së huase nr. 19891 Prot. Tirane, 24.08.2022 me Albcontrol Sh.a., me qëllim mbeshtetjen financiare për garantimin e shërbimi i lundrimit ajror dhe sigurimin e operimit të Albcontrol Sh.a.

Vlera totale e rene dakort për tu financuar është 936,000,000 lekë e cila do të disbursohet në disa këste ku gjatë vitit 2022 janë disbursuar 421,200,000 lekë dhe pjesa tjetër do të disbursohet në vitin 2023.

Financimi i vlerës së huase është mundësuar nga DPSHTRR nga një kontratë overdrafti 12 mujore të nënshkruar ndërmjet DPSHTRR dhe Credins Bank në datë 05/08/2022 me një interes BTH + 1.66% jo më pak se 4.5% (shënimi 17).

Shlyerja e kredise duhet të kryhet deri në dhjetor 2023 duke përfshirë edhe interesin e overdraftit nga Banka Credins. Kredia është e garantuar në rast mospagese me të gjitha likuiditetet dhe depozitat që Albcontrol Sh.a mban në bankat e nivelit të dytë.

12. Llogari të arkëtueshme të tjera

Llogari të arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Të tjera të arkëtueshme	10,926,721	12,840,088
Tatim fitimi i parapaguar	5,809,740	-
Kerkesa personeli	2,979,034	2,998,279
	<u>19,715,495</u>	<u>15,838,367</u>

Në zërin të tjera të arkëtueshme përfshihen dhe vlerat e parave të marra në Durrës në datë 14.12.2018, gjatë transportit me mjetet e shoqërisë së sigurimit fizik, Nazeri 2000 shpk në vlerën 7,267,000 Lek.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

13. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Shpenzime të shtyra	1,906,116	3,880,980
	1,906,116	3,880,980

14. Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Llogari rrjedhëse në bankë	2,652,535,071	2,919,554,704
Depozita	360,121,027	343,801,477
Likuiditete në udhëtim	47,434,475	16,556,161
Likuiditete në arkë	1,459,712	4,425,053
	3,061,550,285	3,284,337,395

Likuiditete në udhëtim përfshijnë fonde të marra në ruajtje nga bankat me të cilat ka marrëveshje Shoqëria. Këto vlera janë kaluar në llogari rrjedhëse në ditët e para të vitit pasardhës. Depozitat përbëhen nga depozita afatshkurtra në leke nga Drejtorite Rajonale në bankat e nivelit të dytë dhe janë me maturitet maksimal 1 muaj dhe norma interesi vjetore që variojnë nga 0,1% deri 1,6%.

15. Kapitali

Sipas statutit të DPSHTRR Kapitali themeltar i shoqërisë përbehet nga fondet e kapitali në momentin e krijimit të DPSHTRR-se, mbi bazen e bilancit të audituar nga ekspertet kontabel në fund të vitit 1999 dhe fondet e rezervave.

Sipas statutit të Shoqërisë, fitimi neto i Shoqërisë shpërndahet si vijon:

- Për krijimin e rezervës së kapitalit në masën 5% të fitimit vjetor neto, por jo më pak se një e dhjeta e shumës së kapitalit.
- Për krijimin e rezervës për zhvillim.
- Për krijimin e rezervës për ndihma sociale në masën 5% të fitimit vjetor neto.
- Për krijimin e rezervës për shpërblim suplementar të punonjësve në masën 15% të fitimit vjetor neto e cila shpërndahet në masën deri në dy paga për secilin punonjës.
- Për krijimin e rezervave të tjera në masën 5% të fitimit vjetor neto.
- Në fund të vitit ushtrimor pjesa e papërdorur e rezervës për ndihma sociale dhe rezervave të tjera të kalojnë në rezerva për zhvillim.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor **Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022**

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

15 Kapitali- vazhdim

Bazuar në performancën financiare të DPSHTRR, ministri përgjegjës për transportin rrugor, me përjashtim të rezervës ligjore, urdhëron derdhjen në buxhetin e shtetit të një pjesë të rezervave të tepërta të krijuara nga fitimet e viteve të kaluara, të cilat nuk janë përdorur por jo më shumë se 25% të tyre.

Kapitali rritet nga shtesat e aktiveve afatgjata gjatë vitit dhe zvogelohet nga daljet nga përdorimi dhe transferimet e aktiveve afatgjata materiale.

Rezervat nga rivlerësimi përbëhen rivlerësimi i aktiveve (shenimi 7). Gjatë vitit 2022 keto rezerva janë pakësuar me vlerën 23,609,370 lekë nga amortizimi i aktiveve në llogarinë fitime të mbartura për të njëjtën vlerë.

Rezerva ligjore është llogaritur sipas Vendimit të Këshillit Drejtues (VKD) nr.27, datë 01.07.2022 "Për miratimin e llogarive vjetore dhe ndarjen e fitimit neto dhe miratimin e kapitalit të vitit 2021" në vlerën jo më shumë se 1/10 e shumës së kapitalit të Shoqërisë.

Rezervat e tjera analizohen si më poshtë:

Rezerva statuale (Rezerva për ndihma sociale), me gjëndje në 31 dhjetor 2022 në shumën 0 lekë, shtuar për vitin 2022 në shumën 29,930,490 lekë, sipas Vendimit të Këshillit Drejtues nr.27, datë 01.07.2022 "Për miratimin e llogarive vjetore dhe ndarjen e fitimit neto dhe miratimin e kapitalit të vitit 2021" dhe është pakësuar në shumën 25,447,440.70 lekë, e shpërndarë me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm, bazuar në Vendimin e Këshillit Drejtues Nr.33, datë 22.07.2022 "Për miratimin e kriterëve të shpërndarjes së fondit për ndihma sociale". Shuma 4,483,049.30 lekë e papërdorur gjatë vitit është transferuar në rezervat për investime në zbatim të Statutit.

Rezerva për shpërblim me gjëndje më 31 dhjetor 2022 në shumën 0 lekë, e shtuar në vitin 2022 sipas Vendimit të Këshillit Drejtues nr.27, datë 01.07.2022 "Për miratimin e llogarive vjetore dhe ndarjen e fitimit neto dhe miratimin e kapitalit të vitit 2021" në shumën 89,791,470 lekë dhe e përdorur gjatë vitit për shpërblim për punonjësit për shumën 81,679,225 lekë sipas VKD. Shuma 8,112,245 lekë e papërdorur gjatë vitit është transferuar në rezervat për investime në zbatim të Statutit.

Rezerva të tjera me gjëndje më 31 dhjetor 2022 në shumën 0 lekë, të shtuara për vitin 2022 në shumën 29,930,490 lekë, sipas Vendimit të Këshillit Drejtues nr.27, datë 01.07.2022 "Për miratimin e llogarive vjetore dhe ndarjen e fitimit neto dhe miratimin e kapitalit të vitit 2021" janë përdorur gjatë vitit 2022, në shumën 7,000,000 lekë për mbështetje financiare për Top Chanel. Shuma 22,930,490 lekë e papërdorur gjatë vitit është transferuar në rezervat për investime në zbatim të Statutit.

Rezerva për investime në shumën debitore 1,010,634,760 lekë. Gjendja në 01.01.2021 në shumën debitore 709,536,014 lekë është shtuar për vitin 2022 në shumën 419,026,858 lekë, sipas Vendimit të Këshillit Drejtues nr.27, datë 01.07.2022 "Për miratimin e llogarive vjetore dhe ndarjen e fitimit neto dhe miratimin e kapitalit të vitit 2021", dhe me shumën 35,525,784 lekë për rezerva ndihma sociale, rezerva për shpërblim dhe rezerva të tjera. Kjo Rezervë është pakësuar/kredituar në shumën 755,651,388 lekë për investimet e kryera gjatë vitit sipas programit të investimeve dhe shkresave përkatëse, për çelje fondi për investime, të pasqyruara si shtesë në aktive afatgjata për vitin 2022.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

16. Grante

Balanca e granteve dhe levizjet e tyre me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021, paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Balanca e mbartur	35,643,783	35,792,778
Shtesa gjatë vitit	-	7,190,309
Pakësime	(7,175,215)	(7,339,304)
Balanca në fund të periudhës	<u>28,468,568</u>	<u>35,643,783</u>

17. Hua afatshkurtër

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Linjë kredie (overdraft)	100,515,733	-
	<u>100,515,733</u>	<u>-</u>

DPSHTRR ka hyrë në një kontratë Overdrafti 12 mujore me Credins Bank në datë 05/08/2022 me një interes BTH + 1.66% jo më pak se 4.5%.

18. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Furnitorë për mallra dhe shërbime	229,997,822	196,440,529
	<u>229,997,822</u>	<u>196,440,529</u>

Furnitore për llogari të pagueshme tregtare përbëjnë kryesisht nga furnitore për investime në aktive afagjtata materiale dhe furnitore për blerje materiale të inventarit.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

19. Detyrime tatimore dhe të tjera

Detyrimet ndaj administratës tatimore dhe njësive të qeverisjes vendore më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Detyrime ndaj Drejtorise së Tatimeve per taksat e mjeteve, lejet e drejtimit dhe gjobat	1,193,844,723	1,073,968,569
Detyrime ndaj bashkive per taksat e mjeteve	369,931,212	292,206,590
TVSH e pagueshme	41,125,033	10,856,364
Sigurime shoqërore dhe shendetësore	33,015,387	26,634,360
Tatimi mbi të ardhurat personale	32,460,705	26,594,130
Tatimi në burim	1,930,442	320,793
Te tjera	133,414	10,000
Tatimi mbi fitimin	-	27,452,813
	1,672,440,916	1,458,043,619

DPSHTRR ushtron veprimtarinë si agjent për mbledhjen e taksave kombëtare të taksës të mjeteve të përdorura të transportit rrugor (TVMP), taksës së regjistrimit fillestar të automjeteve luksoze (TRML) dhe taksa e përvitshme e automjeteve luksoze (TVML) dhe tarifave të paisjes me leje drejtimi, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin Nr.9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", i ndryshuar.

Ne 1 janar 2018, per TVMP DPSHTRR pasi zbret komisionin e saj per sherbimin 5% per TVMP, kalon për njesite e qeverisjes vendore 25% te vleres dhe pjesen e mbetur DPT me FDP e taksave kombetare.

Sipas udhezimit 26, datë 4.9.2008 per Taksat kombetare, i ndryshuar nga 15 janar 2020, per TVML dhe TRML, DPSHTRR perfiton komision sherbimi 5% për mbledhjen e taksave vendore.

DPSHTRR mbledh edhe gjobat për pagese të vonuar te TVMP dhe TVML. Vlera e gjobes për pagesë të vonuar të TVMP dhe TVML, ndahet në raportin 60% me 40%, për DPSHTRR dhe DPT.

20. Llogari të pagueshme të tjera

Llogaritë e pagueshme të tjera më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2022
Detyrime të tjera	39,461,270	39,661,899
Detyrime ndaj personelit	22,938,891	6,113,411
Detyrim për sigurim vullnetar	3,290,827	2,617,460
Detyrime të tjera thesari	15,146,021	3,839,753
	80,837,009	52,232,523

Detyrime te tjera perfshin dhe vleren e shpronesimit te tokes prej 26,904,342 leke, sipas VKM Nr. 471, datë 30.07.2021.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

21. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021
Të ardhura nga regjistrimi i mjeteve	1,167,386,057	1,311,048,841
Të ardhura nga kontrolli teknik	748,484,968	419,715,978
Të ardhura nga leje drejtimi	724,150,313	719,333,551
Të ardhura nga shërbimi DP dhe DTSH	39,265,298	13,927,802
Të ardhura nga shitje të tjera	15,590,478	13,672,589
	2,694,877,114	2,477,698,761

DPSHTRR ofron 173 shërbime për mjetet, si targa, pajisje me leje qarkullimi, identifikim automjetesh, vërtetime etj. Gjatë vitit 2022 është ulur çmimi i tahografit nga 100 euro në vitin 2021 në 40 euro në vitin 2022 dhe është ndryshuar formati i lejes së qarkullimit, nga data 06.06.22, ku leja e re e qarkullimit përfshin në një dokument të vetëm lejen e qarkullimit, certifikatën e pronësisë dhe lejen qarkullimit ndërkombëtare. Çmimi i ri është ulur në 2,100 lekë me TVSH nga 3,500 lekë me TVSH që ishin si dokumente të veçanta. Identifikimi i treguesve të automjeteve (kontrolli fizik), nga viti 2022, nuk do të kryhet për automjetet që janë të regjistruara në Shqipëri dhe kanë certifikatë të vlefshme të Kontrollit Teknik. Më parë, ky shërbim ishte i detyrueshëm për çdo rast kur ndryshonte pronësia e këtyre mjeteve.

DPSHTRR ofron shërbimin e lejes së drejtimit në të gjithë vendin nëpërmjet 13 njesive të Drejtorive Rajonale.

Në muajin maj 2021, shërbimi i kontrollit teknik, u rikthye pranë DPSHTRR, pas përfundimit të koncensionit dhe shoqërisë SGS Automotive Albania shpk.

22. Të ardhura të tjera

Të ardhurat e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021
Të ardhura nga lëvizjet e brendshme	201,528,345	148,942,474
Të ardhura nga gjoba TVML & TVMP	128,847,111	96,825,729
Të ardhura nga gjoba për ndryshim pronësie, KTV dhe Task Force	90,027,243	36,225,126
Të ardhura nga amortizimi i granteve	7,175,215	7,339,305
Të ardhura të tjera	5,253,417	1,705,386
Penalitet kontrata	10,000	982,459
	432,841,331	292,020,479

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

23. Lëndë e pare dhe materiale të konsumueshme

Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021
Blerje e materialeve të para	255,520,301	29,400,290
Furnizime mallra dhe shërbime	206,409,865	189,978,632
Energji elektrike	35,376,794	171,980,300
Shërbime të tjera	14,095,115	2,858,172
	511,402,075	394,217,394

24. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021
Shpenzime paga	1,361,237,391	1,101,800,316
Shperblime dhe të tjera për personelin	250,591,066	198,588,882
Sigurime shoqërore e shendetësore	219,447,396	178,669,397
	1,831,275,853	1,479,058,595

Gjatë vitit DPSHTRR ka të punësuar mesatarisht 1,082 punonjës (2021 - 982 punonjës).

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

25. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Sigurim fizik	162,973,055	157,475,753
Mirëmbajtje dhe riparime	80,784,519	68,260,990
Transferime udhëtime e dieta	17,127,173	11,641,814
Të tjera	15,341,775	10,957,483
Shpenzime postare dhe komunikimi	15,202,597	13,479,298
Sigurime	14,353,624	10,863,711
Gjoha dhe dëmshpërblime	12,703,745	21,804,362
Kontribut për të perndjekurit politik	12,428,922	9,932,969
Qira	8,240,003	18,456,437
Publicitet, reklama	7,974,380	2,992,326
Vlera kontabël e AAM të dala jashtë përdorimit	7,045,820	14,542,026
Shërbime printimi	7,035,361	3,635,817
Subvencione	5,340,300	10,588,035
Honorare Keshilli Drejtues dhe të tjera	4,959,120	4,472,197
Shpenzime transporti	3,944,085	3,428,577
Tatime të tjera	2,291,601	1,573,380
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	1,796,705	524,800
Shërbime konsulence auditimi dhe të tjera	1,710,000	52,650,000
Taksa dhe tarifa vendore	1,678,386	3,060,249
Shërbime bankare	626,671	637,015
	383,557,842	420,977,239

26. Të ardhura nga interesa

Të ardhurat nga interesat për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021
Te ardhura nga interesat e llogarive në banka	34,242,291	40,091,888
Te ardhura nga interresi i huave të dhena	6,922,168	-
Shpenzime për interesa për overdraft	(6,902,783)	-
	34,261,676	40,091,888

Të ardhura nga interesat përbëjnë të ardhurat nga interesat e depozitave dhe llogarive rrjedhëse për të cilat shoqëria ka një marrëveshje me bankën për përfitim interesi.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

27. Të ardhura të tjera financiare

Të ardhurat e tjera financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021
Komisione agjenti për taksa mjetesh	404,449,550	377,601,844
Komisione agjenti për tarifa të lejeve të drejtimit	17,453,100	16,578,725
	421,902,650	394,180,569

DPSHTRR ushtron veprimtarinë si agjent për mbledhjen e taksave kombëtare të: taksa e mjeteve të përdorura të transportit rrugor (TVMP), taksa e regjistrimit fillestar të automjeteve luksoze (TRML) dhe taksa e përvitshme e automjeteve luksoze (TVMPL) dhe tarifave të paisjes me leje drejtimi, sipas përcaktimeve të bera në ligjin Nr.9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", i ndryshuar (shënimi 19).

28. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqitet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021
Fitimi para tatimit	583,470,161	712,956,817
Shpenzime të panjohura	33,424,219	49,356,648
	616,894,380	762,313,465
Fitimi tatimor	15%	15%
Norma e tatim fitimit	15%	15%
Shpenzime tatim fitimi @15%	92,534,157	114,347,020

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

29. Manaxhimi i rrezikut financiar

Aktivitetet e shoqërisë e ekspozojnë atë ndaj një sërë risqesh financiare si: rreziku i kreditit, rreziku i likuiditetit dhe rreziku nga monedhat e huaja. Shoqëria nuk përdor instrumenta financiare derivative ose ndonjë formë tjetër mbrojtje ndaj këtyre rreziqeve.

Objektivat dhe politikat e manaxhimit të rrezikut financiar

Një instrument financiar është çdo kontratë që krijon të drejta për të marrë para ose asete të tjera financiare nga palët e tjera ose detyrimin për të dhënë asete të tjera financiare një pale tjetër. Instrumentat kryesore financiare të Shoqërisë konsistojnë në para në dore dhe në banke, llogari tregtare të arkëtueshme dhe të pagueshme dhe detyrime të tjera financiare. Instrumentat financiare krijojnë një risk për shoqërinë. Risqet më të rëndësishme me të cilat përballet shoqëria janë si vijon:

Rreziku i likuiditeteve

Shoqëria gjeneron flukse të mëdha të parase nga aktivitetet operative në atë mase sa që beson se rreziku i likuiditeteve nuk është domethënës.

Tabelat e mëposhtme të likuiditetit janë ndërtuar bazuar në maturitete kontraktuale të paskontuara të aktiveve dhe detyrimeve financiare:

Përshkrimi	31 dhjetor 2022		
	deri në 1 vit	mbi 1 vit	Totali
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	29,420,820	-	29,420,820
Hua të dhena	429,099,135	-	429,099,135
Mjete monetare në arkë dhe bankë	3,061,550,285	-	3,061,550,285
Totali	3,520,070,240	-	3,520,070,240
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(310,834,831)	-	(310,834,831)
Hua afashkurter	(100,515,733)	-	(100,515,733)
Detyrime Tatime/bashki	(1,672,440,916)	-	(1,672,440,916)
Totali	(2,083,791,480)	-	(2,083,791,480)
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2022	1,436,278,760	-	1,436,278,760
Përshkrimi	31 dhjetor 2021		
	deri në 1 vit	mbi 1 vit	Totali
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	21,335,913	-	21,335,913
Mjete monetare në arkë dhe bankë	3,284,337,395	-	3,284,337,395
Totali	3,305,673,308	-	3,305,673,308
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(248,673,052)	-	(248,673,052)
Detyrime Tatime/Bashki	(1,458,043,619)	-	(1,458,043,619)
Totali	(1,706,716,671)	-	(1,706,716,671)
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2021	1,598,956,637	-	1,598,956,637

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

29 Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Rreziku i normave të interesit

Të ardhurat si dhe rrjedhja e parave nga aktiviteti i shfrytëzimit i shoqërisë nuk kanë një ndikim material nga përqindjet e interesit. Shoqëria nuk ka financime në formën e huamarrjeve. Shoqëria përballë me riskun e normave të interesit të fluksit të parasë lidhur me rrezikun e normave të interesit të llogarive rrjedhëse dhe depozitave afatshkurtër.

Rreziku nga monedhat e huaja

Rreziku nga monedhat e huaja është rreziku që vlera e instrumentave financiare do të luhetet si pasojë e ndryshimeve në kurset e kembimit të monedhave të huaja. Shoqëria i kryen aktivitetet e saj kryesisht në monedhë lokale ndaj ekspozimi ndaj rrezikut të monedhave të huaja është minimal.

Tepricat sipas monedhave detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021:

Përshkrimi	31 dhjetor 2022		
	Lekë	Te tjera	Total
Llogari tregtare të arketueshme dhe të tjera	29,420,820	-	29,420,820
Hua të dhena	429,099,135	-	429,099,135
Mjete monetare në arkë dhe bankë	3,013,381,324	48,168,961	3,061,550,285
Totali	3,471,901,279	48,168,961	3,520,070,240
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(310,834,831)	-	(310,834,831)
Hua afatshkurtra	(100,515,733)	-	(100,515,733)
Detyrime Tatime/Bashki	(1,594,716,256)	-	(1,594,716,256)
Totali	(2,006,066,820)	-	(2,006,066,820)
Rreziku i monedhes më 31 dhjetor 2021	1,465,834,459	48,168,961	1,514,003,420

Përshkrimi	31 dhjetor 2021		
	Lekë	Te tjera	Total
Llogari tregtare të arketueshme dhe të tjera	21,335,913	-	21,335,913
Mjete monetare në arkë dhe bankë	3,231,257,451	53,079,944	3,284,337,395
Totali	3,252,593,364	53,079,944	3,305,673,308
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(248,673,053)	-	(248,673,053)
Detyrime Tatime/Bashki	(1,458,043,619)	-	(1,458,043,619)
Totali	(1,706,716,672)	-	(1,706,716,672)
Rreziku i monedhes më 31 dhjetor 2021	1,545,876,692	53,079,944	1,598,956,636

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

29 Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Analiza e ndjeshmërisë të efekteve të ndryshimeve në kursin e këmbimit në fitimin neto më poshtë është përcaktuar në bazë të ekspozimit ndaj monedhës së huaj në datën e raportimit të mbajtur konstante gjatë gjithë periudhës. Analiza e mëposhtme përlogarit efektet e mundshme të lëvizjes së kursit të këmbimit kundrejt monedhës vendase LEK (të gjithë variablat e tjera janë konstante) në pasqyrën e fitim humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (për shkak të vlerës së drejtë të ndjeshmërisë së aktiveve dhe detyrimeve monetare) dhe kapitalit (nuk ka kapital të veçantë apo instrumente mbrojtëse, të cilat ndikojnë në ndjeshmërinë e kapitalit, rrjedhimisht efekti është i njëjtë si ndjeshmëria e pasqyrës së fitim humbjes.

Një vlerë negative në tabelë paraqet një humbje potenciale neto në fitim ose humbje në pasqyrën e fitim humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse ose kapitalit, në pasqyrën e pozicionit financiar një vlerë pozitive reflekton një mundësi rritjeje. Një zvogëlim ekuivalent në monedhat e tjera më poshtë kundrejt monedhës vendase do të ndikojë në një impakt të kundërt ekuivalent.

	100 bp	100 bp	50 bp	50 bp
	Rritje	Rënie	Rritje	Rënie
Më 31 dhjetor 2022	481,689	(481,689)	240,845	(240,845)
Më 31 dhjetor 2021	530,799	(530,799)	265,400	(265,400)

Risku i kreditit

Klientët e shoqërisë, ne pjesën më të madhe, paguajnë në momentin që marrin shërbimin me para në dore ose në bankë. Balanca e llogarive të arkëtueshme monitorohet në vazhdimësi në mënyrë që rezultati i ekspozimit të shoqërisë ndaj borxheve të keqija të mos jetë i konsiderueshem. Përsa i përket balancave të tjera si mjete monetare dhe hua afatshkurter Shoqëria i vlerëson me nivle të ulët të rrezikut të kredit për shkak të maturitetit të tyre të ulët dhe vleresimit (rating) të lartë të institucioneve financiare me të cilat bashkëvepron.

Përqëndrimi i rrezikut të kreditit të shoqërisë në është si më poshtë vijon:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Mjetet monetare në bankë	3,060,090,573	3,279,912,342
Hua të dhëna	429,099,135	-
Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	29,420,820	21,335,913

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

30. Palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura të përfshira në pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 detajohet si më poshtë:

	31 dhjetor 2022		31 dhjetor 2021	
	Aktive	Detyrime	Aktive	Detyrime
Albcontrol Sh.a.	429,099,135	-	-	-
	429,099,135	-	-	-

Transaksionet me palët e lidhura të përfshira në pasqyrën e performancës për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 detajohet si më poshtë:

	31 dhjetor 2022		31 dhjetor 2021	
	Te ardhura	Shpenzime	Te ardhura	Shpenzime
Interesa Albcontrol Sh.a.	7,899,135	-	-	-
	7,899,135	-	-	-

Balanca dhe veprime me administratoret dhe këshillin mbikëqyrës

Pagat dhe shpërblimet e administratorit të DPSHTRR, përfshirë administratoret e Drejtorive Rajonale dhe Këshillit Mbikëqyrës përshihen në shpenzimet e personelit dhe analizohen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021
Administratorët	44,605,289	39,788,530
Këshilli drejtues	5,536,261	3,275,536
	50,141,550	43,064,066

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

31. Detyrime të kushtëzuara

Çështje gjyqësore

Shoqëria është e përfshirë në çështje gjyqësore të ndryshme gjatë rrjedhës normale të biznesit. Në gjykimin e Drejtimit rezultati final i këtyre çështjeve nuk do të ketë një impakt material në rezultatin aktual të shoqërisë.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

Angazhime të tjera

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Angazhime për huanë e dhëne	514,800,000	-
	<u>514,800,000</u>	<u>-</u>

Vlera totale e kredise se miratuar është 936,000,000 lekë e cila do të disbursohet në disa këste ku gjatë vitit 2022 janë disbursuar 421,200,000 lekë dhe pjesa tjetër do të disbursohet në vitin 2023 (Shënimi 11).

Angazime për qiranë operationale.

Shoqëria ka lidhur një kontratë qiraje toke me Bashkinë Fier me afat 10 vjecar më efekt prej 1 tetor 2021 për përdorim nga Drejtoria rajonale e shërbimit të transportit rrugor Fier. Angazimet e qirasë me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë.

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Angazhime për qira operationale	44,604,000	48,384,000
	<u>44,604,000</u>	<u>48,384,000</u>

32. Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka asnjë ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit financiar e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.